



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK HIMARË

Nr. 4925 prot.

Himarë, më 03.07.2026

VENDIM

Nr. 36 datë 30.06.2026

**“PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË DESTINACIONIT TË PJESËS SË
PAPËRDORUR TË FONDIT TË PROGRAMIT TË SHËRBIMIT LËVIZËS
SOCIAL”**

Në mbështetje të nenit 54, shkronja “dh”, dhe nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 1446, datë 11.02.2026, ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë: Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 30.06.2026 pasi shqyrtoi materialin e sjell nga drejtoria e çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë e miratoi me pesëmbëdhjetë (15) vota pro, zero (0) vota kundër, zero (0) vota abstenim dhe si mëposhtë,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e destinacionit të pjesës së papërdorur të fondit të akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të programit të Shërbimit Lëvizës Social, për periudhën janar 2026 – qershor 2026, e krijuar si rezultat i mosrealizimit të plotë të shpenzimeve për pagesat e specialistëve të programit.
2. Të miratojë përdorimin e fondit të papërdorur të parashikuar për pagesat e specialistëve (psikolog, fizioterapist dhe koordinator programi) për financimin e shërbimeve mbështetëse të përfituesve të programit, konkretisht:
 - sigurimin e pakove ushqimore;
 - sigurimin e medikamenteve;

- mbulimin e nevojave të tjera të domosdoshme të përcaktuara në planin individual të ndërhyrjes së përfituesve të Shërbimit Lëvizës Social, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

3. Drejtoria e financës, parashikimit të buxhetit dhe menaxhimit të aseteve dhe Drejtoria e çështjeve sociale, e arsimit dhe e rinisë ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

